

Editorët

Prof. Dr. Mürteza Bedir
Prof. Dr. Necmettin Kızılkaya
Dr. Merve Özaykal

Përktheu: Dr. Fation Shabani



Modernizimi **Protestantizimi** **Selefizimi**

Instrumentalizimi i tekstit hyjnor
(nass) në mendimin modern islam

iDEFE

MODERNIZIMI
PROTESTANTIZIMI
SELEFIZIMI

Instrumentalizimi i tekstit hyjnor (nass) në mendimin modern islam

Editorët

Prof. Dr. MÜRTEZA BEDIR

Prof. Dr. NECMETTIN KIZILKAYA

Dr. MERVE ÖZAYKAL

Përshtati nga turqishtja në gjuhën shqipe

Dr. FATION SHABANI

MODERNIZIMI, PROTESTANTIZIMI, SELEFIZIMI

Instrumentalizimi i tekstit hyjnor (nass) në mendimin modern islam

TITULLI I ORIGJINALIT

MODERNLEŞME, PROTESTANLAŞMA VE SELEFİLEŞME

Modern İslam Düşüncesinde Nassın Araçsallaştırılması

Editörler: Murteza Bedir, Necmettin Kızılkaya, Merve Özyakal

İsar Yayınları, İstanbul 2019



Boton: Shoqata për Edukim dhe Mendim Fettah Efendi-IDEFE

Kolana : STUDIME | 02

Përktheu : Fation Shabani

Kryeredaktor : Sevba Abdula

Redaktor : Shpetim Hiseni

ISBN : 978-608-4944-07-2

Dizajni : Seyfullah Bayram

Shtypi : Ajgraf Skopje, 1000, Cair-Skopje, North Macedonia

Botimi i parë, Shkup 2022

Tirazhi :1000

©IDEFE

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet riprodhimi, transmetimi apo kopjimi i këtij libri në tërësi pa lejen paraprake me shkrim të botuesit.

IDEFE

Pushkarska No.01, Cair-Skopje, North Macedonia

Tel: +38970728470

fettahefendi.com, idefe.org

**MODERNIZIMI
PROTESTANTIZIMI
SELEFIZIMI**

Instrumentalizimi i tekstit hyjnor (nass) në mendimin modern islam

Editorët

Prof. Dr. MÜRTEZA BEDIR

Prof. Dr. NECMETTIN KIZILKAYA

Dr. MERVE ÖZAYKAL

Përshtati nga turqishtja në gjuhën shqipe

Dr. FATIÖN SHABANI

Murteza Bedir

Ka lindur në Sivas të Turqisë në vitin 1968. Në vitin 1992 përfundoi arsimin universitar në Fakultetin e Teologjisë, pranë Universitetit Marmara. Në vitin 1993 filloi të punojë si asistent në Universitetin Sakarya dhe në vitin 1994 shkoi në Angli për të përfunduar studimet pasuniversitare me bursë të ofruar nga Këshilli i Arsimit të Lartë të Turqisë. Përfundoi masterin në Fakultetin Juridik “School of Oriental and African Studies” (SOAS), pranë Universitetit të Londrës (LLM, 1996). Ka doktoruar në Departamentin e Studimeve të Lindjes së Mesme, Fakulteti i Arteve dhe Shkencave, Universiteti i Manchesterit, me tezën të titulluar “zhvillimi i hershëm i Teorisë Juridike Hanefite (usuli-fikh) (1999). Më pas (2000) filloi të punojë si asistent profesor në Fakultetin e Teologjisë të Universitetit Sakarya. Në vitin akademik 2002-2003 ka bërë kerkime shkencore në Siri me bursë të Ministrisë së Arsimit të Sirisë. Në vitin 2005 mori titullin profesor i asociuar dhe vazhdoi të punojë si profesor i asociuar në Universitetin Sakarya deri në fund të vitit 2010. Në vitin akademik 2007-2008 ka bërë hulumtime dhe ka dhënë mësim në Fakultetin Juridik të Universitetit të Harvardit. Në janar të vitit 2011 filloi të punojë si profesor në Fakultetin Teologjik të Universitetit të Stambollit, anëtar i të cilit është edhe sot. Nga viti 2013 deri në vitin 2020 ka shërbyer si dekan i të njëjtit fakultet. Në vitin 2015 u emërua si përfaqësues i Turqisë në Akademinë Ndërkombëtare të Fikhut që i përket Organizatës së Konferencës Islamike. Në gusht të vitit 2015 u zgjodh anëtar i Këshillit të Lartë të Çështjeve Fetare të Turqisë. Flet mirë arabishten dhe anglishten. Është i martuar dhe ka katër fëmijë.

Necmettin Kızılkaya

Në vitin 2001 kreu studimet universitare në Universitetin e Marmarasë, Fakulteti i Teologjisë dhe po aty mbaroi masterin në degën e Drejtësisë Islame. Në vitin 2011 përfundoi doktoraturën mbi të Drejtën Islame në Institutin e Shkencave Sociale të Universitetit Selçuk. Hulumtimet e tij shkencore fokusohen kryesisht në ligjin dhe ekonominë islame. Veçanërisht është i interesuar për historinë e ligjit islam, modernizimin dhe fikhun, literaturën juridike islame, ekonominë islame dhe problemet aktuale të fikhut. Kızılkaya, i cili ka shumë artikuj të botuar në gjuhë të ndryshme në fushën e së drejtës islame, vazhdon studimet e tij si pedagog në Universitetin e Stambollit, Fakulteti i Teologjisë, Departamenti i së Drejtës Islame.

Merve Özaykal

Në vitin 2008 përfundoi studimet universitare në Fakultetin e Teologjisë, Universiteti i Ankarasë dhe po aty kreu masterin në Departamentin e të Drejtës Islame (2010). Gjatë viteve 2009-2013 studioi shkencat klasike islame pranë Qendrës së Shkencave dhe Arteve (ISM). Gjatë vitit akademik 2013-2014, mori trajnime dhe bëri hulumtime për bioetikën në Institutin e Etikës Kennedy (The Kennedy Institute of Ethics), pranë Universitetit Georgetown. Në vitin 2016 kreu masterin në Universitetin e Stambollit, Fakulteti i Mjekësisë, Departamenti i Historisë dhe Etikës dhe në vitin 2017 mbaroi doktoraturën në Universitetin Sakarya, Fakulteti i Teologjisë, me tezën e titulluar “E drejta mbi trupin e njeriut dhe autorizimi i transplantimit të organeve sipas ligjit islam”. Që nga viti 2018 punon si asistente profesor në Fakultetin e Teologjisë në Universitetin e Stambollit.

Përmbajtja

Në Vend të Parathënie.....	ix
Parathënie	xiii

HYRJE

Diskursi kuranor dhe sunetor, usuli-fikhu dhe ixhtihadi: një ese shpjeguese lidhur me lindjen e nassit modern	1
<i>Mürteza Bedir</i>	

KAPITULLI I PARË

MODERNIZMI, KTHIMI NË TEKSTIN E SHENJTË DHE SELEFIZMI

Një çelës për analizën e selefizmit: transformimi i relacionit të teori-vëzhgimit në zhvillimin e shkencave moderne	48
<i>Ahmet Ayhan Çitil</i>	
Disa vëzhgime mbi selef(sti)zmin dhe modernizmin	57
<i>Tahsin Görgün</i>	
Selefizmi: ideologjia e intversionit dhe lokalitetit.....	64
<i>H. Yunus Apaydın</i>	
Sola Scriptura dhe tradita në hermenutikën e Gadamerit	77
<i>Selami Varlık</i>	
Hermeneutika A-Historike e Spinozës*	100
<i>Mahmut Salihoglu</i>	

Ad Fontes! (*kthimi te burimet*) hermeneutika biblike dhe epistemologjia
në agimin e reformimit..... 106

Torrance Kirby

KAPITULLI I DYTË

RRËNJËT E INSTRUMENTALIZMIT TË NASSIT

Pozicionimi shkencor dhe politik i dhahirizmit nga sunizmi qendror..... 126

Oğuzhan Tan

Nuk ka literalistë: sunitë e hershëm dhe interpretimi i hapur në teologji dhe
jurisprudencë..... 155

Jonathan AC Brown

Koncepti fikhor i Ahmed b. Hanbelit..... 160

Halil Efe

Koncepti fikhor i Ibn Tejmijjes..... 188

Soner Duman

Lëvizjet ihjâ (*rigjallëruese*) në shekullin e 18-të: shembulli i
Shah Velijjullah ed-Dihleviut 205

Dr. Ahmet Aydın 205

Skicat e mendimit reformues të shevkaniut dhe përpjekjet e tij në
transformimin e usuli-fikhut 228

Dr. Nail Okuyucu

KAPITULLI I TRETË

EPOKA E KËRKIMEVE TË REJA NË INTERPRETIMIN E TEKSTEVE HYJNORE (NASSEVE)

Koncepti reformues i Reshid Ridas dhe projekti i shkollës davet (thirrja) dhe
irrhâd (orientim/udhëzim)..... 244

Özgür Kavak, Assoc. Prof. Dr.

Projekti për bërjen e ligjeve me një qasje ndërmedhhebore para gjysmë shekullit
të themelimit të Dekretit i Kodit Familjar (Hukûk-ı Âile Kararnâmesi): Komiteti i
Fikhut (Cemiyet-i Fikhiyye)

Sümeyye Sarıtaş..... 283

Tekstualizëm pa usul (principe/rregulla): Mendimi bashkëkohor islam midis historizmit ose selefizmit 295

Recep Şentürk

Nga ehli-hadithi te shkolla e kuranijunëve dhe lëvizja ‘Progressive Muslims’: instrumentalizmi i tekstit dhe evolucioni i përjetuar në konceptin e fesë me në qendër tekstin..... 309

Necmettin Kızılkaya

Vlerësimi i ligjërimet “Islami Kuranor” sipas usuli-fikhut (rasti i Turqisë) 344

Kaşif Hamdi Okur

Një pikë kthese e rëndësishme në studimet e Kuranit: çështja e abrogimit (nes’hit) 370

Davut İltaş

Profetologjia luftarake, sira dhe hadithi: disa qasje në teologjinë akademike islame në dritën e referencave xhihadiste ndaj Profetit Muhammed (s.a.v.) 424

Ruggero Vimercati Sanseverino

NË VEND TË PARATHËNIE

Një nga ndryshimet ose transformimet më të mëdha në historinë botërore është padyshim lindja e individit modern, shoqërisë, shtetit, politikës, kulturës dhe ekonomisë moderne. Ky transformim, i cili mundësoi kalimin nga shoqëria bujqësore në shoqërinë industriale, njëkohësisht shndërroi, shkatërroi dhe rikonstrukttoi strukturat, sistemet dhe normat klasike, që kishin mbijetuar (pa ndonjë ndryshim të madh) për mijëra vjet. Ky fenomen i ri, i përcaktuar kryesisht nga dinamikat e brendshme të vendeve evropiane, duke bërë ndryshime të mëdha në përkufizimet e termeve si Zoti, universi, natyra dhe njeriu e imponoi këtë dukuri në të gjitha pellgjet kulturore dhe civilizuese asokohe. Gjatë këtij procesi krishterimi themeloi një doktrinë të re, ku marrëdhënia e tij me shtetin ishte mjaft e kufizuar.

Ndërsa qytetërimi islam dhe shoqëritë myslimane, kësaj shtate të re, e cila fillimisht u shfaq në Evropë, por që u përhap shumë shpejt dhe ndikoi të gjithë botën, nuk mundën t'i kundërpërgjigjeshin këtij fenomeni në aspektin ushtarak, politik, ekonomik dhe kulturor. Elitat myslimane u përpoqën ta kuptonin këtë shtatë të re dhe t'u gjenin zgjidhje problemeve të saj në forma të ndryshme si miratimi i saj por pa hequr dorë nga karakteristikat vetjake ose duke u transformuar plotësisht. Rënia e Perandorisë Osmane, e cila ishte kalaja e fundit e qytetërimit islam, në fund të këtij procesi shkaktoi një krizë të madhe në shkencat, kulturën dhe artin e themeluar më parë nga shoqëritë myslimane që jetonin në vende të ndryshme të botës, dhe u bë shkak që myslimanët të përqëndroheshin vetëm në ekzistencën si mysliman. Për arsye të këtyre konflikteve që vazhdonin në Anadollin e Turqisë, u ndërpreu zhvillimet shkencore, të cilat ishin pasqyrë e një kulture të lartë, dhe u dobësuan analizat dhe këndvështrimet e studimeve shkencore për botën moderne.

Kurse vendet e Evropës Lindore që ishin nën sundimin osman u përballën shumë më herët me fenomenin e modernizimit që nga fillimi i shekullit të 19-të. Perandoria Osmane duke u përballuar veçanërisht me problemet politike të këtyre vendeve, në përgjithësi nuk arriti t'i përgjigjej kërkesave të tyre. Si rezultat i luftërave në shekullin e 20-të osmanët u tërhoqën nga rajoni ballkanik dhe kjo rezultoi në migrimin e popullsisë me kulturë të lartë urbane drejt Anadollit. Kur kësaj situatë të vështirë iu shtuan edhe elementë të tillë si presioni sistematik, asimilimi dhe dëbimi i aplikuar nga shtetet e sapokrijuara ndaj myslimanëve të rajonit, myslimanët që mbetën në statusin e pakicës, gjatë këtij shekulli u përqendruan vetëm në ruajtjen e kulturës dhe ekzistencës së tyre. Si rezultat i të gjithë këtyre rrjedhjeve, myslimanët e këtij rajoni për arsye se nuk kishin mundësi t'i gjenin zgjidhje problemeve të reja shkencore, institucionale, kulturore, politike dhe ekonomike u detyruan të pranonin format e modernizimit.

Popullsia myslimane e Ballkanit, e cila humbi fuqinë e saj politike, demografike, kulturore dhe shkencore, luftoi vetëm për ekzistencë gjatë gjithë shekullit të 20-të. Ishin myslimanët ata të cilëve iu mbyllën shkollat, që iu nënshtruan sekularizimit të ashpër jakobist, të cilëve u uzurpuan të drejtat e gjuhës, fesë dhe arsimit, të cilëve nuk i lejohej organizimi institucional etj. Me një periodizim dhe përkufizim tjetër, mund të themi se identitetet e myslimanëve u shtetëzuan midis viteve 1918-1945, u laicizuan midis viteve 1945-1990 dhe u kristalizuan pas vitit 1990 me demokratizimin. Edhe pse kalimi në demokraci pas viteve '90 ka pasur shumë aspekte pozitive në krahasim me periudhat e tjera, identiteti mysliman u kristalizua me luftën për të zbuluar ekzistencën e strukturave të brendshme dhe të jashtme në jetën publike.

Paaftësia e myslimanëve të Ballkanit për të transformuar traditën e medresesë klasike në fakultete teologjike (përveç Sarajevës) gjatë shekullit të 20-të shkaktoi një ndërprerje në shkencat islame. Dhe pamundësia për të prodhuar njohuri të reja në këto disiplina ndikoi në zbulimin e strukturave të ndërlikuar që u shfaqën në periudhën moderne. Si rrjedhojë e kësaj, tensioni që pritej të ndodhte si rezultat i ballafaqimit me shkencat moderne nuk ndodhi dhe Islami popullor ishte fokusuar vetëm në ruajtjen e disiplinave klasike të dijes. Mungesa e një terreni konfrontues me shkencat moderne dhe pamundësia për të prodhuar informacione të reja ndikoi negativisht në zhvillimin e botimeve të reja. Pas vitit 1990, me terrenin e krijuar nga demokratizimi dhe liberalizimi, filluan të hyjnë në jetën tonë të mendimit përkthime jo sistematike nga qarqe dhe shkolla të ndryshme të botës islame. Edhe pse këto përkthime të bëra nga vende dhe rryma të ndryshme jashtë Ballkanit sollën njëfarë gjallërie në fushën e shkencave islame, e cila ishte pezulluar për një shekull, mungesa e një terreni për të bërë

lexime kritike të së resë, pati një ndikim negativ në praktikën e mendimit islam në Ballkan.

Kjo vepër u përkthye në gjuhën shqipe me shpresën se do të kontribuojë dhe do të mbushë disa nga mangësitë e sipërpërmendura. Para së gjithash, duhet theksuar se Stambolli është një nga qarqet shkencore më të afërta të kuptimit të Islamit dhe njohurive të prodhuara në vendet ballkanike. Prandaj e shohim shumë të rëndësishme që mjedisi shkencor i Stambollit, i cili ka përjetuar shumë tensione gjatë dy shekujt e fundit midis dilemave shkollat medrese klasike-fakultetet teologjik, disiplinat islame-shkencat laike, ligji islam-ligji modern, modernizmi-tradita/klasikja, dhe veçanërisht diskutimet mbi shkencat islame të përkthehen sistematikisht në gjuhët ballkanike. Edhe pse myslimanët që jetojnë në vendet ballkanike tani për tani janë jashtë sistemit publik, ka shumë mundësi që në një periudhë të afërt të përjetojnë të njëjtat tensione në jetën publike.

Ky libër i përgatitur nën bordin editorial të Prof. Dr. Mürteza Bedir, Prof. Dr. Necmettin Kızılkaya dhe Dr. Merve Özaykal me titull: modernizimi, protestantizimi dhe selefizimi, në të cilin marrin pjesë shumë artikuj të intelektualëve të mirëfilltë, shqyrton strukturën e përgjigjeve të dhëna për shumë probleme të lindura në dy shekujt e fundit me të cilat po përballet bota islame dhe shkencat islame, veçanërisht ligji islam, dhe shqyrton kufijtë dhe kornizën e këtyre zhvillimeve në një stil akademiko-shkencor. Është fakt se proceset e modernizimit, protestantizimit dhe selefizimit si dukuri me të cilat po përballen të gjitha shoqëritë dhe shkencat islame, po ashtu kanë ndikuar, prekur dhe transformuar edhe shoqëritë ballkanike.

Ne, si shtëpi botuese IDEFE, do të përpiqemi për të botuar punime shkencore, përkthime dhe edicione mbi veprat bazë të shkencave islame, diskutimet dhe ekolet e ndryshme, me qëllim që të fitojmë sërish vrull në mendimin islam në vendet ballkanike. Fokusi jonë në botimin e librave është akademiko-shkencor. Së fundmi dëshirojmë të falënderojmë Dr. Fation Shabanin dhe shtëpinë botuese İSAR për punën e tyre në botimin e këtij libri.

Sevba Abdula

PARATHËNIE

Ideja e daljes në pah të këtij libri për herë të parë u shfaq në seminarët e usuli-fikhut (اصول الفقه), i cili u zhvillua për disa vite me radhë nën Fondacionin Stamboll për Studim dhe Edukim (Istanbul Araştırma ve Eğitim Vakfı-ISAR). Zhvillimi i kësaj ideje u maturua në takimin ndërkombëtar të titulluar “modernizimi, protestantizimi dhe selefizimi: instrumentalizimi i nassit (tekstit hyjnor) në interpretimet moderne islame”, të mbajtur me datë 22-24 shtator 2017, dhe më në fund kjo ide mori formën e saj përfundimtare dhe iu prezantua lexuesit në formën e një libri të veçantë.

Seminarët e usuli-fikhut, duke u mbështetur në librin e fundit klasik të usulit *Mexhâmi’u’l-Hakâik* të dijetarit të njohur të shekullit të 18-të, Ebu Said el-Hadimi, synonte të merrej me çështjet themelore të metodologjisë klasike të fikhut duke i lidhur ato me problemet e interpretimit aktual islam.

Në sesionet e këtyre seminareve është përqendruar më shumë në interpretimin e *Kuranit* dhe *Sunetit*, ku këto pjesë përbëjnë më shumë se gjysmën e tërësisë së librave klasikë të usulit të shkruar me metodologjinë *Hanefite të Usulit* (në arabishte quhet *tarîkatu’l-fukahâ*). Gjithashtu, janë lexuar dhe krahasuar shumë mendime bashkëkohore që kanë hyrë në botën tonë të mendimit në kohën moderne.

Siç dihet, aventura e modernizimit, veçanërisht në Evropën Perëndimore, por duke përfshirë edhe botën islame, për një kohë të gjatë është kthyer në një fenomen që përfshin gjithë botën dhe është përhapur në të gjitha fushat e mendimit dhe veprimit. Ashtu si fushat e tjera tradicionale islame të dijes, edhe shkenca e fikhut si një disiplinë në të cilën myslimanët shqyrtojnë marrëdhëniet midis shpalljes (*vahj*) dhe arsyes (*akl*) në nivelin teorik, duhet të lexohet, diskutohet dhe zhvillohet me ide të reja në lidhje me çështjet aktuale teorike.

Përkundër qasjes së përgjithshme të dijetarëve klasikë (të fikhut), leximet moderne të usuli-fikhut e perceptojnë këtë shkencë si një metodë të rindërtimit

të dispozitave të sheriatit (*ahkâmu'sh-sharî'a*) bazuar në metodën krahasuese të fikhut (*el-Fikhu'l-mukâren*), e cila mund të quhet “fikhu i ri” që u shfaq në periudhën moderne, ku duket se kjo metodologji e re e ka lënë pas dore rolin më të madh dhe më kompleks teorik të fikhut klasik. Edhe një koncept komplet teorik/filozofik si *Mekâsidu'sh-sherî'a* (qëllimet/objektivat e sheriatit) është shndërruar në një mjet të thjeshtë teknik në qasjen e re të usulit. Dijetarët klasikë të usulit e kanë parashikuar disiplinën e usuli-fikhut si një teori e njohurive dhe vlerave duke e vendosur atë në një terren të shëndoshë të ekuilibrit shpallje-logjikë (*vahj-akl*). Për këtë arsye, ata preferuan të merren me pyetjet teorike në lidhje me fushën e filozofisë praktike brenda kornizës së kësaj shkence. Prandaj, pyetjet aktuale teorike dhe problemet e shkencës së linguistikës, filozofisë së gjuhës, filozofisë së ligjit, etikës dhe fushave të ngjashme normative janë diskutuar në thellësi brenda disiplinës së usuli-fikhut. Teoritë klasike islame të interpretimit, që u zhvilluan midis skajeve të mendimit ezoterik (*bâtini*) dhe literalist (*dhâhiri*), synuan të kuptonin arsyen dhe vahjin mbi një bazë të saktë dhe të ekuilibruar brenda fushës së shkencës së usuli-fikhut. Me fjalë të tjera, shkencë e usulit kryesisht u përqendrua në nevojat teorike të mendimit të interpretimit islam duke synuar të demonstrojë përpjekjen për krijimin e një lidhjeje të shëndetshme të së vërtetave hyjnore me akumulimin njerëzor brenda kornizës së një discipline shkencore. Kështu, usuli-fikhu synonte t'i vendoste kuptimet interpretuese islame mbi një bazë filozofike/epistemologjike.

Për këtë arsye, pyetjet e semantikës (së Kuranit) nuk mund të lexohen pa iu referuar shkencës së usulit në mënyrë që të analizohet se si të arrihet kuptimi objektiv i Kuranit. Duke ndërtuar një teori racionale të transmetimeve (*haberrivâjet*), shkencë e usuli-fikhut i dha kuptim statusit teorik të Sunetit në mendimin islam. Megjithëse pretendimi i Islamit që zotëron “të vërtetën” e cila do të zgjasë deri në ditën e kijametit, ku për jomyslimanët këtë e shqyrton shkencë e kelamit, argumentimi i pretendimit të vërtetës si një debat i brendshëm për myslimanët është realizuar po nga disiplina e usulit. Dhe së fundmi, falë shkencës së usulit, myslimanët vizatuan kornizën e marrëdhënies midis interpretimit njerëzor (*ixhtihâd*) dhe tekstit hyjnor (*nass*). Akumulimi i shkencës së usulit në këtë fushë të quajtur *ixhtihad* përbën një rën nga literaturat më të pasura teorike të mendimit islam. Në këtë kontekst, usuli-fikhu, nga njëra anë ka të bëjë me shkencën e linguistikës/gjuhësisë, filozofinë operacionale, logjikën dhe logjikën koherente, ose kriteret e vlefshmërisë së një argumenti; dhe nga ana tjetër, themelon kornizën teorike se si duhet të lexohet mesazhi universal hyjnor i shprehur në një vend e në një periudhë kohore të caktuar, dhe në një kontekst specifik lokal. Reduktimi i një shkence që merret me çështje të tilla jetësore,

teorike e shkencore në një “mjet ose metodë teknike” të thjeshtë, është shkak i mjaftueshëm për të prishur natyrën e kësaj shkence në botën islame sot. Sepse kuptimi dhe literatura moderne e usuli-fikhut e pa të panevojshme të merrej me të gjitha këto pyetje komplekse dhe u mundua ta thjeshtonte metodën e fikhut sa më shumë që të ishte e mundur. Dhe duke e parashikuar shkencën e usulit si një mekanizëm për rindërtimin e dispozitave fetare nga e para, e ka minimizuar thellësinë, domethënien intelektuale dhe kontributin e saj filozofik. Ky studim diskuton shumë metoda të zhvilluara nga myslimanët mbi çështjet që hyjnë në interesin e shkencës së usulit në kohën moderne.

Nëse është e nevojshme për të bërë një shpjegim rreth tre termave në titullin e këtij libri, kur themi *Modernizëm*, në fakt po flasim për një fenomen që u shfaq në Perëndim në shekujt e fundit dhe, megjithëse është përdorur për periudha të tjera të historisë, duke i dhënë kuptime krejtësisht të tjera si diçka e re, moderne dhe bashkëkohore, ky term na paraqitet si fundi i botës dhe pika më ideale e njerëzimit. Ky fenomen, i cili transformoi rrënjësisht botën për sa u përket besimeve, vlerave dhe praktikave, që nga shekulli i 19-të çoi në një ndryshim të thellë e të vazhdueshëm, së pari në Krishterizëm, më pas në Judaizëm, dhe së fundi në Islam dhe fetë e tjera.

Sa i përket *Protestantizmit*, ai është një fenomen në të cilin ndoshta mund të shohim efektin transformues më konkret të modernizimit mbi një fe. Në fakt, Evropa Perëndimore e kuptonte modernizimin dhe protestantizimin si një fenomen paralel të ndërlidhur me njëri-tjetrin. Pritja që ky fenomen përfundimisht të miratohet nga anëtarët e feve të tjera është ende e fortë. Për të përshkruar thelbin interpretues të teologjisë fetare protestante si një kthim në tekstin hyjnor të shenjtë, duhet të jetë i saktë, të paktën për shekullin e parë të kësaj lëvizjeje. A mund të themi se transformimi i madh në teoritë interpretuese të miratuara së pari në Krishterizëm dhe më pas në Judaizëm po ndodh gradualisht për shoqëritë myslimane që nga dy shekujt e fundit? Nuk ka dyshim se ka shenja të tilla dhe kjo na sjell te fjala e fundit: *Selefizimi*.

Selefizmi u shfaq me synimin për të rivendosur një kuptim “të kulluar/të pastër” të Islamit në shoqëritë myslimane duke u kthyer në epokën e artë, në dy tekstet e shenjta të shekullit të artë; në gjuhën dhe botën e *Kuranit* dhe *Hadithit*. A është e mundur të shihet Selefizmi si një lëvizje kthimi të “Teksti i Shenjtë” si një koncept interpretimi? Kuptimi i kthimit në Islamit e pastër, i cili u themelua në shekullin e 18-të, filloi të tregonte efektin e tij gjerësisht në elitat myslimane në fillim të shekullit të 20-të. Me fjalë të tjera, thirrjet për t’u kthyer në Kuran dhe Sunet, së pari u shfaqën në formën e leximit të Islamit duke u bazuar vetëm në ajetet kuranore dhe tekstet hadithore. Në një kohë kur modernizimi, si një

projekt kolektiv, rriti efektet e tij në botën islame në fushat politike, juridike, arsimore dhe fusha të ngjashme, ku njëkohësisht shohim se thirrjet për kthim në Kuran dhe Sunet si një kuptim i interpretimit fetar filluan të gjenin terren. Këtu duhet të theksojmë se ne e kuptojmë Selefizmin si një term i përgjithshëm. Kur themi Selefizëm, nuk i kemi për qëllim vetëm ata të cilët e quajnë veten Selefi, por po flasim për një fenomen që ndihet ndikimi i tij pothuajse në të gjitha mendimet dhe interpretimet bashkëkohore islame. Ajo që nënkuptojmë këtu është kuptimi i planifikimit të projekteve shpëtuese dhe recetave shëruese bazuar në tekstet kuranore dhe hadithore. Nga ky aspekt, mund të themi se sot Selefizmi ka ndikuar traditat kryesore të interpretimit islam.

Ekzistojnë ngjashmëri midis mentalitetit *Ehli-Hadith* dhe atij *Selefi*, i cili është një mënyrë e të menduarit që është shfaqur dhe forcuar herë pas here që nga periudhat e hershme të historisë islame dhe disa lëvizjeve të shfaqura në periudhën moderne. Këto ngjashmëri tregojnë se disa aspekte të lëvizjeve moderne janë formuar duke u frymëzuar nga Selefizmi klasik. Megjithatë ekzistojnë disa dallime midis këtyre mënyrave të të menduarit që nga e kaluara në të tashmen, të gjitha këto në thelb bashkohen në pretendimin e kthimit në burimet themelore të Islamit dhe në burimin unik. Sot, rrymat dërrmuese dhe ndikuese, të cilat mund të cilësohen me mentalitetin “*islamizëm tekstori*”, pretendojnë të largohen nga mendimi i usuli-fikhut, zhvlerësojnë traditën dhe nuk i shohin medhhebet (shkollat) e fikhut si mjete legjitime për t’i kuptuar, interpretuar dhe jetuar në një mënyrë të shëndetshme burimet islame. Gjithashtu, ka ngjashmëri serioze midis mënyrës selefiste të të menduarit, e cila ka një qëndrim reduktues në mbrojtjen e idesë së kthimit në bazat (e Islamit) duke e bërë jofunksionale dhe të panevojshme përvojën historike dhe me pretendimin se e kanë gjetur të vërtetën e vetme e imponojnë atë, dhe kuptimeve që e paraqesin veten e tyre si progresive dhe moderne. Po ashtu, mentaliteti i përbashkët midis Protestantizmit, i cili mbron kthimin në tekstin e shenjtë dhe lëvizjeve të tilla selefiste në botën islame është një dukuri që na tërheq vëmendjen. Këtu qëndron një çështje që ia vlen të diskutohet se si lëvizja selefiste, duke e refuzuar mendimin e shkencës së fikhut dhe praktikën/përvojën njerëzore, duke i vendosur në qendër tekstet e shenjta (Kuranin dhe hadithet) dhe duke u mbështetur në autoritetin e këtyre teksteve, ka arritur të hapë rrugë në shkëputjen e zinxhirit të mendimit modern islam nga mendimi i tij klasik.

Për shembull, si një situatë paradoksale, në këtë kuptim edhe mendimet e Fazllurrahmanit mund t’i interpretojmë si një shembull të selefizmit. Padyshim që të gjithë ithtarët e feve të ndryshme dhe në veçanti myslimanët, të cilët pretendojnë që Islami është i vlefshëm në të gjitha kohërat dhe vendet, duhet ta

interpretojnë fenë e tyre në përputhje me kohën dhe sipas kushteve të veçanta që posedojnë. Përndryshe, detyrohen ta braktisin pretendimin e vlefshmërisë së fesë. Ne e dimë se tradita e shkencës islame e quan atë *tahkîk*¹ dhe pranon që ajo gjithmonë do të jetë e nevojshme. Por, në pikën e arritur sot, qasjet e interpretimit islam (bashkëkohor) janë shumë larg dhe mbrapa nga thellësitë intelektuale klasike, pa lerë më t'i tejkalojnë ato. Në këtë rast, qëndron si një sfidë e rëndësishme domosdoshmëria e kritikimit të kornizave të reja të interpretimit në aspektin shkencor.

Ky libër, me një total prej njëzet artikujsh, përbëhet nga një hyrje dhe tre kapituj kryesorë. Në artikullin e tij të titulluar “diskursi i Kuranit dhe Sunetit, usulifiku dhe ixhtihadi: një ese shpjeguese lidhur me lindjen e nassit modern”, e cila është dhe hyrja e këtij punimi dhe gjithashtu zbulon qasjen e përgjithshme të studimit, Mürteza Bediri përshkruan fenomenin që e emërton atë si tekstualizëm (*nassizëm*) modern dhe i cili është dominues në mendimin bashkëkohor islam. Po ashtu, ai duke u bazuar në arsyet/shkaqet historike dhe teorike shpjegon se nga ka ardhur ky fenomen. Bedir argumenton se historia e dispozitave të Islamit dhe proceset e argumentimit të këtyre dispozitave nga shkolla dhe grupe të ndryshme të mendimit duhet të lexohen duke i ndarë ato nga njëra-tjetra.

Ndodhën gjashtë shkrime në kapitullin e parë kryesor me kryetitull *MODERNIZMI, KTHIMI TE TEKSTET E SHENJTA DHE SELEFIZMI*. Artikulli i Ahmet Ayhan Çitilit me titull “një çelës për analizën e selefizmit: transformimi i relacionit të teori-vëzhgimit në zhvillimin e shkencave moderne”, në të cilin thuhet se sot ekziston një metafizikë e re e bazuar në shkenca dhe e cila është një mënyrë e të menduarit e lindur nga modernizmi. Ai thekson se selefizmi, duke hedhur poshtë traditën dhe duke iu afruar arsyes me dyshim, është një lloj mendimi i lindur nga modernizmi dhe e trajton atë si një armik i dobët për t'u kapërcyer lehtësisht në fazën që ka arritur modernizmi. Çitili argumenton se myslimanët, për të ndërtuar të ardhmen e tyre në një mënyrë të shëndetshme, kanë nevojë për një qasje të re që vlerëson plotësisht zhvillimet aktuale pa i shkëputur lidhjet me traditën, që interesohet për studimin e natyrës po aq sa tekstet hyjnore dhe që kritikon rrënjësisht botëkuptimin modern të shkencave natyrore. Tahsin Görgüni, në artikullin e titulluar “disa vëzhgime mbi selefizmin dhe modernizmin”, thekson tri pika: kuptimin origjinal dhe real/thelbësor të selefizmit, kuptimin që ai fitoi me kolonizimin dhe cilësitë themelore të përbashkëta të selefizmit dhe modernizmit. Görgüni shprehet se termi selefizëm u përdor në kundërshtim me kuptimin e tij klasik në procesin

1 Studim i thelluar në fushat e shkencave të ndryshme (sh. i prkth.)

e kolonizimit/modernizimit dhe e emërton atë si “selefistizëm” në mënyrë që të mos ngatërrohet koncepti me kuptimin e tij origjinal (selef). Në artikullin e tij të titulluar “selefizmi: ideologjia e introversionit dhe lokalitetit”, H. Yunus Apaydını pretendon se mentaliteti selefist, edhe pse origjina e tij është më e hershme, ku fillimisht filloi të shfaqej në kohën e Tabiunëve, veçanërisht që nga Ibn Tejmijje, është shndërruar në një diskurs të veçantë që ka pësuar disa ndryshime dhe është një version i mentalitetit të ehli-hadithit i cili mbijeton deri më sot. Nga ky aspekt, Apaydını e trajton selefizmin si një ideologji të introversionit mbi marrëdhënien *ngjashmëri-vazhdimësi*.

Selami Varlıku, në artikullin “*Sola Scriptura* dhe Tradita në Hermenutikën e Gadamerit” përpiket të tregojë se ideja e *Sola Scriptura*-s përjashton vetëm ato që nuk bazohen drejtpërdrejt në tekst, sesa të gjitha mënyrat e të kuptuarit të ofruara nga tradita dhe autoriteti. Varlıku, pasi demonstroi se në mendimin e Gadamerit ka një lloj përqendrimi tekstor dhe se perceptimi i tij ndaj traditës është i hapur për formimin e mënyrave të reja të të kuptuarit për sa kohë që teksti plotëson horizontet e reja të historisë dhe nuk i atribuon një status të veçantë dhe të pandryshueshëm ndonjë autoriteti. Nga ky aspekt, ai e mbron këtë si një traditë në kontekstin e mendimit islam. Mahmut Salihoğlu, në artikullin e titulluar “Hermeneutika A-historike e Spinozës” shqyrton metodën e interpretimit të Spinozës, i cili ishte një nga të parët që zhvilloi një metodë për interpretimin e Biblës. Sipas Salihoğlus, Spinoza, me metodën e interpretimit që ai zhvilloi e reduktoi Biblën në një produkt të përpiluar nga njerëzit. Sipas kësaj, Spinoza, i cili parashikoi një marrëdhënie statike midis tekstit dhe lexuesit, e vlerëson procesin hermeneutik si zbulimin e një kuptimi statik dhe të pavarur nga historia. Në artikullin “Ad Fontes! (*Kthimi te Burimet*) Hermeneutika Biblike dhe Epistemologjia në Agimin e Reformimit”, Torrance Kirby, përqendrohet në interpretimin biblik të reformizmit Protestant që filloi me Rilindjen e Humanizmit në Evropën Veriore. Në këtë kontekst, ajo zbulon se si përkthimi i Biblës në gjuhën latine nga Erasmusi ndezi reformizmin Protestant dhe si lindi Lutheri nga kjo ide.

Artikulli i parë në kapitullin e dytë *Origjina e Instrumentalizimit të Tekstit* shkruar nga Oğuzhan Tan titullohet “Pozicionimi Shkencor dhe Politik i Dhahirizmit nga Sunizmi Qendror”. Autori i nënshtron marrëdhëniet midis *qendrës sunite* dhe *dhahirizmit* në një analizë të procesit në tri periudha. Në këtë kontekst, ai i shpjegon marrëdhëniet midis qendrës sunite dhe dhahirizmit bazuar në faktin se të dy boshtet kanë përmbajtje, kuptime dhe imazhe që ndryshojnë nga koha në kohë. Artikulli i Jonathan AC Brownit i titulluar “nuk ka literalistë: sunitë e hershëm dhe interpretimi i hapur në teologji dhe jurisprudencë” së pari thotë se koncepti i ehli-hadithit në periudhat e hershme korrespondonte

me ehi-sunetin dhe dijetarët e këtij grupi, siç kuptohen sot, nuk i interpretonin tekstet e Kuranit dhe Sunetit në mënyrë literale. Në veçanti, Browni shqyrton disa hadithe të transmetuara nga Tirmidhiu dhe Ebu Davudi dhe interpretimet e bëra mbi to, si dhe shpjegon se si dijetarët aplikonin *te'vilin*.

Në artikujt e tjerë të këtij kapitulli, studiohen emra të tillë si Ahmed b. Hanbeli, Ibn Tejmijje, Shah Velijjullah ed-Dihleviu dhe Shevkaniu. Halil Efe, në artikullin e tij “koncepti fikhor i Ahmed b. Hanbelit” përqendrohet mbi Ahmed b. Hanbelin i cili është një nga referencat historike të mendimit selefist teskto-centrik (duke u bazuar vetëm në tekstet hyjnore) që përpiqet të kuptojë fenë dhe të prodhojë njohuri nga tekstet kuranore dhe sunetore. Efe, duke e konsideruar efektin transformues të ngjarjes *Mihne* si sfond historik, shqyrton kuptimin fikhor të Ahmed b. Hanbelit dhe diskuton se në çfarë mase mund të jetë referencë mendimi i tij selefist. Në artikullin me titull “koncepti fikhor i Ibn Tejmijjes”, Soner Dumani, deklaron se thirrjet për “reformë” dhe “kthim në origjinë”, të cilat shpesh sillen në rendin e ditës në botën islame, veçanërisht i referohen Ibn Tejmijjes, po ashtu pikëpamjet/mendimet e Ibn Tejmijjes kanë një ndikim mbizotërues ndaj lëvizjeve reformuese dhe ato selefiste në periudhën moderne, të cilat bazohen në leximet fetare të përqendruara vetëm mbi tekstet hyjnore. Nga ky këndvështrim, ai përpiqet të zbulojë mendimin metodologjik (usulor) të Ibn Tejmijjes, konceptimet e tij mbi nocionet themelore të fikhut dhe tiparet karakteristike të mendimit të tij fikhor.

Artikulli i Ahmet Aydinit “lëvizjet ihja (rigjallëruese) në shekullin xviii: shembulli i Shah Velijjullah ed-Dihleviut” studion Shah Velijjullahun, i cili ishte përfaqësuesi më i shquar i lëvizjeve *ihjâ/texhdîd* (rigjallërim/ripërtëritje) në nënkontinentin indian që u shfaqën në rajone të ndryshme të botës islame në shekullin e 18-të. Aydini përqendrohet në mendimin e Shah Velijjullahut ndaj medhhebeve, në mendimin e bashkimit të medhhebeve, theksimin e mundësisë së tranzicionit midis mdhhebeve dhe pikëpamjet e tij mbi ixhtihadin dhe taklidin (imitimin). Artikulli me titull “skicat e mendimit reformues të Shevkaniut dhe përpjekjet e tij në transformimin e usuli-fikhut” i shkruar nga Nail Okuyucu, pretendon se Shevkaniu zhvilloi një ide reformuese gjithëpërfshirëse që synonte të transformonte të gjitha shkencat fetare dhe i cili u përpoq ta bënte këtë nëpërmjet shkencë së usuli-fikhut. Nga ky aspekt, Okuyucu shqyrton konceptimin e Shevkaniut ndaj usuli-fikhut, mendimet rreth ixhtihadit dhe taklidit, kritikën mbi medhhebet dhe qëndrimin e tij negativ ndaj koncepteve dhe klasifikimeve fikhore.

Ekzistojnë shtatë artikuj në kapitullin *EPOKA E KËRKIMEVE TË REJA NË INTERPRETIMIN E TEKSTEVE HYJNORE*. Në artikullin e tij të titulluar “koncepti

reformues i Reshid Ridas dhe projekti i shkollës davet (thirrje) dhe irshad (orientim/udhëzim)” Özgür Kavaku, fillimisht merret me mendimin reformues të Reshid Ridas dhe më pas shqyrton mendimin e tij fikhor modern. Më vonë, ai analizon kurikulën e projektit të tij të quajtur Shkolla e Davetit dhe Irshadit në lidhje me përpjekjet për të forcuar kuptimin reformues të tij. Artikulli i Sümeyye Sarıtaşit me titull “projekti për bërjen e ligjeve me një qasje ndërmedhheboe para gjysmë shekullit të Dekretit të Kodit Familjar (*Hukûk-ı Âile Kararnâmesi*): Komiteti Fikhor (*Cemiyet-i Fikhiyye*)” nëpërmjet Statutit të Komitetit Fikhor (*Cemiyet-i Fikhiyye Nizamnâmesi*), shqyrton sfondin e kalimit nga qasja njëmedhheboe në Mexhel’le drejtë qasjes ndërmedhheboe në Dekretin e Ligjit të Familjes. Sarıtaşı analizon përmbajtjen e këtij statuti (*Nizamnâmesi*) duke marrë parasysh kontekstin në të cilin është shkruar. Artikulli i Recep Şentürkut i titulluar “tekst pa usul (principe/rregulla): mendimi bashkëkohor islam midis historizmit ose selefizmit” përcakton se efekti më i rëndësishëm i modernizmit mbi të gjitha fetë qëndron në zëvendësimin e kuptimit shumëdimensional të ontologjisë dhe epistemologjisë fetare duke i shndërruar ato në një kuptim materialist unik të ekzistencës dhe në një kuptim pozitivist të njohurive dhe metodës. Më pas, Şentürku shpjegon se Islami është një civilizim dhe se qasjet selefiste dhe historike sot priren ta asgjësojnë këtë civilizim dhe parimet themelore të tij duke ndërtuar një fe të parregullt me një kuptim puritan.

Artikulli me titull “nga ehli-hadithi te shkolla e kuranijjunëve dhe lëvizja progressive muslims: instrumentalizmi i tekstit dhe evolucioni i përjetuar në konceptin e fesë teksto-centrike” i shkruar nga Necmettin Kızılkaya, shqyrton nocionin e fesë teksto-centrike dhe pasqyrimet e saj. Kızılkaya merret me procesin e ndërtimit të njohurive fetare nëpërmjet tekstit hyjnor duke filluar nga lëvizja e ehli-hadithit që u shfaq në nënkontinentin indian dhe reflektimet e saj aktuale. Artikulli i Davut İltaşit me titull “një pikë kthese e rëndësishme në studimet e Kuranit: çështja e nes’hit” së pari shqyrton teorinë e nes’hit që u formua nga dijetarët e usullit dhe e cila u miratua gjithashtu nga mufessirët (komentatorët e Kuranit) e periudhës klasike. Bazuar në këtë, İltaş thekson tezat dhe arsyet e tyre të paraqitura brenda kornizës së pretendimeve themelore të atyre që refuzojnë nes’hin duke thënë se “nuk ka asnjë ajet të shfuqizuar (mensûh) në Kuran”. Kaşif Hamdi Okur, në artikullin e tij “vlerësimi i diskursit “Islami Kuranor” sipas usuli-fikhut (rasti i Turqisë)”, së pari paraqet sfondin historik të diskursit Islam, pastaj shqyrton argumentet kryesore të kësaj rryme duke qëndrur mbi disa figura në Turqi. Më pas, i vlerëson tezat e tyre, me anë të usuli-fikhut. Ruggero Vimercati Sanseverino, në artikullin e tij të titulluar “profetologjia luftarake, sira dhe hadithi: disa qasje në teologjinë akademike islame në dritën e referencave

xhihadiste ndaj Profetit Muhammed (s.a.v.)”, përqendrohet në qasjet xhihadiste ndaj imazhit të Profetit Muhammed (s.a.v.) dhe se si studimet moderne islame e perceptojnë atë. Sanseverino, tregon se si imazhi i Pejgamberit (s.a.v.) u soll në një dimension të sekularizuar nën ndikimin e modernizimit.

Shumë njerëz kanë kontribuar në përgatitjen e këtij libri, i cili do të plotësojë një boshllëk të rëndësishëm në literaturën mbi selefizmin dhe modernizimin dhe do të hapë dyert e kërkimeve të reja. Së pari, dëshirojmë të falënderojmë të gjithë autorët që me shkrimet e tyre të vlefshme kontribuan nëdaljen në pah të këtij libri. I jemi mirënjohës Fondacionit ISAR, i cili organizoi ciklin e seminateve të usuli-fikhut, ku aty u hodh ideja kryesore e këtij libri, dhe që kontriboi në organizimin e simpoziumit dhe përgatitjen e librit. Ne gjithashtu falënderojmë Ömer Said Gülerin dhe Metin Nooratanin për korrigjimin dhe leximin përfundimtar të teksteve. Po ashtu, dëshirojmë të shprehim mirënjohjen tonë ndaj Shtëpisë Boutes ISAR e cila realizoi bashkimin e librit me lexuesin.

Mürteza Bedir

Necmettin Kızılkaya

Merve Özaykal